

ONLINE DISKUTIM

Politikat e kujtesës dhe Praktikat e përkujtimit në Evropën Juglindore

Transkriptë

E enjte, 22.10.2020. në 17:00 h
organizuar nga
KOMRA Rrjeti për Pajtim dhe FDH Kosovë



Mirëdita dhe mirë se keni ardhur panelistë dhe pjesëmarrësë në panel. Tash për tash janë 30 pjesëmarrës në panel, por ky numër, besoj, do të rritet ndërsa ne vazhdojmë me panelin.

Gjatë dy dekadave të fundit, një larmi e politikave të kujtesës nga poshtë-lart dhe lart-poshtë dhe e praktikave të kujtesës kanë evoluar në Evropën Juglindore. Ato politika dhe praktika janë pjesë përbërëse e kujtesës kolektive të vendosura kryesisht brenda kornizave kombëtare dhe karakterizohen nga llogari të ndryshme të së kaluarës, simboleve dhe përfaqësimeve të kontestuara në sferën publike. Përkundër këtij sfondi, paneli do të diskutojë mbi dinamikën dhe modelet e politikave të kujtesës dhe të praktikave të përkujtimit në Evropën Juglindore, por, më konkretisht, ne do të përqendrohemi në shtetet post-jugosllave. Bisedat në panel do të përqendrohen në tri grupe pyetjesh të përcaktuara gjerësisht, por të ndërlidhura njëra me tjetrën, të cilat përfshijnë si vijon:

Së pari, si vazhdon të jetojë e kaluara në të tashmen dhe si i jep formë politikës së kujtesës dhe praktikave të përkujtimit sot? Pyetja e dytë është: Cilat janë trendet kryesore në politikën dhe praktikën e kujtesës? Dhe pyetja e tretë është: Si i ka formësuar aktivizmi i kujtesës politikën e kujtesës dhe në çfarë mënyre ka kontribuar në krijimin e një vizioni të përbashkët për të ardhmen?

Ne kemi mysafirë të dalluar në panelin tonë, dhe unë jam shumë e lumtur t'iu prezantoj juve. Ata janë: Ana Milosheviq, Vjerran Pavllakoviç, Naum Trajanovski dhe Venera Çoçaj.

Më lejoni të vazhdoj me prezantimet e panelistëve. Unë do të filloj me Ana Milosheviqin. Ajo është hulumtuese postdoktorale në Institutin për Kriminologji, Leuven, në Bruksel, Belgjikë. Ajo e ka përfunduar doktoraturën e saj në temën “Evropianizimi i politikës së kujtesës në Kroaci dhe në Serbi” dhe ka botuar shkrime gjerësisht mbi kujtesën kolektive, identitetin dhe integrimin evropian të shoqërive pas konfliktit, me fokus të veçantë në pajtimin me të kaluarën. Ajo e ka bashkë-redaktuar një vëllim të librit me titullin “*Politikat e kujtesës të evropianizimit në Ballkanin Perëndimor*” me Tamara Troshtin, botuar në vitin 2020. Në kërkimin aktual, Ana shqyrton rolet e caktuara në proceset e kujtesës

në lidhje me terrorizmin, me fokus në vlerësimin kritik të efektivitetit të tyre për viktimat, për të mbijetuarët dhe për shoqëritë në përgjithësi.

Vjerran Pavllaković është profesor i asociuar në Departamentin e Studimeve Kulturore në Universitetin e Rijekës, në Kroaci. Ai e ka marrë titullin e doktorit të shkencave në histori në vitin 2005 në Universitetin e Uashingtonit dhe ka botuar artikuj mbi kujtesën kulturore, drejtësinë tranzicionale në ish-Jugosllavi dhe Luftën Civile Spanjolle. Botimet e fundit të Vjerranit përfshijnë një vëllim të bashkë-redaktuar me Davor Paukovićin, *“Kornizimi i kombit dhe identiteti kolektiv: Rituale Politike dhe Kujtesa Kulturore e Traumave të Shekullit XX në Kroaci”*, botuar nga Routledge në vitin 2019, *“Përkujtimi i diskutueshëm: Qasjet Transnacionale për të Kujtuar Bleibergun”*, në *Politika misao (Mendimi politik)*, (2018) dhe *“Vullnetarët Jugosllavë në Luftën Civile Spanjolle”* (2016). Ai aktualisht është studiuesi udhëheqës në projektin Memoryscapes si pjesë e Kryeqytetit Evropian të Kulturës në Rijekë në vitin 2020.

Naum Trajanovski është kandidat për doktor shkence në sociologji në Institutin e Filozofisë dhe Sociologjisë në Akademinë e Shkencave të Polonisë. Ai e ka gradën MA në Studimet e Evropës Juglindore dhe Studimet e Nacionalizmit. Ai ishte i lidhur me Rrjetin Evropian të Kujtesës dhe të Solidaritetit si dhe me Fakultetin Filozofik, në Shkup. Interesat e tij kryesore akademike përfshijnë politikën e kujtesës në Maqedoninë e Veriut dhe transferimin e njohurive sociologjike të viteve 1960-të në Evropën Lindore. Botimi i tij më i fundit është monografia *“Muzeu i Operacionit: Muzeu i Luftës Maqedonase dhe Politika e Kujtesës Maqedonase”* (në gjuhën maqedonase).

Venera Çoçaj është kandidats për doktor shkence në Institutin Evropian, Shkolla Londineze e Ekonomisë dhe Shkencë Politike - (LSE). Kërkimi i saj i doktoraturës është pjesë e një projekti më të madh kërkimor shkencor të titulluar «Ndërveprimet në Drejtësi dhe Ndërtimi i Pages nga Diskurset Statike në Dinamike përmes çështjeve Gjinore Kombëtare Etnike dhe Grupmoshat», financuar nga Këshilli Evropian i Kërkimit. Hulumtimi i saj përqendrohet në dhunën seksuale të kohës së luftës dhe dhunën me bazë gjinore në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë.

Para se të fillojmë me prezantimet e panelistëve tanë, do të doja të jap disa detaje teknike. Paneli transmetohet drejtpërdrejt në kanalin YouTube dhe Facebook të KOMRA-s. Përkthimi ofrohet për të gjithë panelin nga shqip në anglisht, dhe anglisht në shqip si dhe nga boshnjakisht-ser-

bo-kroatisht në anglisht dhe anasjelltas. Ju mund të gjeni poshtë në ekran shenjë për interpretim, me anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht. Pjesëmarrësit në panel që mund të kenë nevojë për përkthim, mund të zbulojnë se përkthimi në shqip ofrohet në kanalën gjerman, kurse në kanalën francez ofrohet përkthimi për gjuhën boshnjake-serbo-kroate.

Pjesëmarrësit, të cilët dëshirojnë të përfshihen në diskutim mund të ngrenë dorën; kur flisni, ju mund të përdorni kamerat tuaja, ose, nëse vendosni të mos e ndizni kamerën, edhe kjo është në rregull. Nëse vendosni të bëni pyetje pa folur, atëherë këtë mund ta bëni duke përdorur opsionin e bisedës. Ju lutem mos ngurroni të vendosni për mënyrën më të mirë për t'u përfshirë në bisedim rreth temës së panelit të sotëm.

Tash, pa humbur kohë, do të doja t'i jepja fjalën Anës.

Ana Millosheviq

Faleminderit Vjollca. Faleminderit që më ftuat të flas sot për këtë temë shumë të rëndësishme. Sot, unë jam këtu në një rol të dyfishtë. Në njërin anë, dua t'i them disa fjalë për Grupin Rajonal të Asociacionit së Studimeve të Kujtesë që e bashkë-kryesoj me Naumin dhe Vjeranin, bashkë-kryesuesit e mi të dashur në Grupin e Kujtesës të Evropës Juglindore. Dhe, së dyti, unë jam gjithashtu këtu si dikush që ka punuar gjërësisht në politikën e kujtesës në rajon, veçanërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Dhe, siç e thatë, Vjollca, në fillim të prezantimit të shkurtër që e bëtë për punën time, në të vërtetë, vëllim i ri që unë e kam bashkë-redaktuar me Tamara Troshtin, shqyrton efektet e evropianizimit të politikës së kujtesës në Ballkanin Perëndimor. Por, për këtë do të doja të flisja pak më shumë më vonë.

Tash, vetëm disa fjalë për grupin rajonal që kemi për Evropën Juglindore, i cili merret në mënyrë specifike me kujtesën e rajonit. Është një grup rajonal i sapo formuar brenda asociacionit së studimeve të kujtesës. Është foshnja jonë e vogël 'Covid-19'. Ne e kemi konceptuar atë gjatë kohës Covid-19 dhe tash po përpiqemi ta ndihmojmë atë të rritet.

Dhe, së dyti, po, ajo për të cilën doja të flisja në të vërtetë janë disa nga idetë që Tamara dhe unë, si dhe autorët tanë i kemi paraqitur në vëllimin e redaktuar që ka të bëjë me evropianizimin e kujtesës. Është një qasje krejt e re ndaj politikës së kujtesës në Ballkanin Perëndimor, ndaj vendeve, të cilat,

në të vërtetë, kanë një të kaluar të përbashkët, por që jetojnë të ardhme të ndara e, megjithatë, mund të kenë një të ardhme së bashku përsëri në Bashkimin Evropian (BE). Ajo, të cilën ne vërtet e kemi shikuar në këtë libër, në 10 kapituj empirikë të saj, por edhe në hyrjen teorike që e kemi punuar së bashku, është, në të vërtetë, se si integrimet evropiane kanë ndikuar në politikën e kujtesës në Ballkanin Perëndimor. Ne i kemi vëzhguar vendet - shtatë vende - të cilat janë në faza të ndryshme të procesit të integritetit evropian, duke e shtruar pyetjen nëse në nivelin evropian ka diçka që mund ta quajmë kujtesë evropiane dhe nëse në procesin e integritetit evropian, në procesin e evropianizimit nga këto vende, ne mund të shohim ndryshime dhe, nëse ka ndryshime, cilat janë ato ndryshime. Ky ishte një proces mjaft sfidues; dhe unë e kam shqyrtuar Serbinë dhe Kroacinë në më shumë detaje, sepse kjo ishte tema e tezës së doktoraturës sime. Por, me këtë vëllim të redaktuar kemi ofruar një analizë të efekteve të evropianizimit në shtatë vende të Ballkanit Perëndimor. Gjetja kryesore e hulumtimit tonë është se nuk ka diçka të tillë që mund ta quajmë kujtesë evropiane.

Nuk ekziston një gjë e tillë si diçka që mund të quhet kujtesë evropiane. Ekziston politika e kujtesës së BE-së, e cila është rezultat i negociatave të vazhdueshme midis vendeve anëtare për atë që ishte Evropa dhe për atë se çfarë është në të vërtetë Evropa për momentin, si dhe lidhur me atë se çfarë aspiron të bëhet Evropa. Kjo politikë e kujtesës së BE-së formohet nga përvojat historike, nga identitetet dhe, natyrisht, nga interesat politike të vendeve anëtare të saj. Dhe kjo është një politikë e kujtesës. Ajo që kemi parë në këtë vëllim ishte pyetja: cilat ishin pasojat pozitive dhe negative të përafrimit me politikën e kujtesës së BE-së.

Më lejoni të them disa fjalë për atë se çka nënkuptoj kur them, “Politika e Kujtimit të BE-së”. Me kalimin e kohës, ne kemi vërejtur, si në nivelin evropian ashtu edhe në nivelin ndërkombëtar, një koncept që po shfaqet, që ne e quajmë politika e kujtesës e BE-së, e që është mënyra se si vendet anëtare të BE-së ngarkojnë përvojat historike në nivelin evropian. Ata kërkojnë njohjen e atyre përvojave. Dhe ishte gjëja më e spikatur pas zgjerimit të vitit 2004 të vendeve të Evropës Qendrore-Lindore. Ajo që kishim para vitit 2004 ishte, në të vërtetë, një lloj mirëkuptimi i përgjithshëm, një konsensus midis vendeve të Evropës Perëndimore se, e dini, kishte një luftë dhe se kjo luftë mbaroi, dhe kishte një Holokaust, dhe ishte një ngjarje që ishte ndjerë në të gjithë botën. Dhe kjo është diçka që nuk duhet të përsëritet kurrë. Ekzistonte konsensusi se lufta kishte mbaruar si dhe një mirëkuptim i përbashkët që, duke punuar së bashku, duke besuar në paqe, ne mund të ecim përpara. Ajo që, në të vërtetë, ndodhi në vitin 2004 me

anëtarësimin në BE të vendeve të Evropës Qendrore është ky, le të themi, investimi që vendet e reja anëtare të BE-së të përkufizojnë politikën e tyre kombëtare të kujtesës në lidhje me normat e kujtesës së BE-së, të cilat unë, gjithashtu, i kam shqyrtuar në nivelin e BE-së.

Po, ajo që e kam vërejtur në nivelin e BE-së - niveli transnacional, është sesi institucionet e caktuara evropiane merren me përvojat historike të shteteve të tyre anëtare. Kam parë se si ndërtohet korniza e kujtesës e BE-së. Ajo që dua të them me këtë është, që kam vërejtë se si vendet anëtare dhe përfaqësuesit e shteteve anëtare, veçanërisht në Parlamentin Evropian, promovojnë diskurse dhe narrativa të caktuara dhe një përdorim të së kaluarës, që janë më të dukshmet në rezolutat e bëra nga Parlamenti Evropian, ku ky konsensus midis Lindjes dhe Perëndimit është një shikim i thjeshtësuar i së kaluarës. Por pikëpamja e thjeshtësuar për të kaluarën është ndërtuar brenda Parlamentit Evropian dhe më pas është zbatuar në politikat që janë miratuar nga Komisioni Evropian, për shembull, në lloje të ndryshme të programeve dhe të iniciativave të financimit që kërkojnë të gjejnë një lloj konsensusi dhe ri-pacifikimi në marrëdhëniet midis Lindjes dhe Perëndimit, midis llojeve të ndryshme të pikëpamjeve të së kaluarës, veçanërisht pas vitit 1945.

Korniza e kujtesës së BE-së, siç e kam quajtur unë, është eksportuar në një farë mënyre në vendet të cilat kërkojnë të bëhen anëtare të BE-së. Këto vende, siç janë vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe, gjithashtu, Ukraina dhe vendet e tjera me këto aspirata, po përpiqen të imitojnë identitetin e BE-së duke u përafruar me normat e përkujtimit të BE-së. Ajo që e kemi parë në këtë libër është, në të vërtetë, mënyrat se si vendet dhe përfaqësuesit politik të vendeve në Ballkanin Perëndimor po përpiqen ta bëjnë atë. Si rreshtohen ato me normat dhe me politikat e përkujtimit të BE-së? Ne kemi arritur në përfundimin se ky është një proces përzgjedhës. Vendet e Ballkanit Perëndimor, për të treguar që i përkasin Evropës dhe se janë vende evropiane, marrin në mënyrë selektive përvojat dhe politikat që lidhen me të kaluarën evropiane dhe i shkarkojnë ato në politikën kombëtare të kujtesës.

Përmes numrit të studimeve të paraqitura në vëllimin e redaktuar, ne mund të shohim lloje të ndryshme të rreshtimeve brenda vendeve të rajonit, varësisht edhe nga faza, në të cilën vendi ndodhet tash në procesin e integritimeve evropiane. Për ta bërë atë me të vërtetë, me të vërtetë të shkurtër, le ta them kështu: vendet, të cilat janë më të përparuara në proces, po përpiqen të imitojnë format e Holokaustit të përkujtimit, duke krijuar, për shembull, politikën e pendimit me anë të krijimit

të muzeve që përputhen me normat evropiane të Holokaustit, që ekzistojnë në Evropë. Por, ajo që ata gjithashtu e bëjnë është shkarkimi i këtij lloj rrëfimi anti-totalitar, i cili ka qenë mjaft i pranishëm, në nivelin evropian, dhe ajo që dua të them me këtë dhe me rrëfimin totalitar është fakti se të gjitha regjimet totalitare, pavarësisht nga origjina e tyre ideologjike ose orientimi, vendosen në të njëjtin nivel. Një numër autorësh kanë shkruar për këtë. Unë nuk dua të përsëris atë që kam thënë në të kaluarën, por thelbësore për një numër rezolutash nga Parlamenti Evropian, ajo që është vendosur, është refuzimi i regjimeve totalitare, i antisemitizmit dhe i ksenofobisë, të përfaqësuar përmes një numri të rezolutave të cilat janë shkarkuar në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Tash, ajo që ndodh është fakti se aktorët politikë, që, në të vërtetë, avokojnë për këtë lloj adaptimi të normave evropiane të kujtesës, po e bëjnë atë për interesin e tyre personal dhe në kërkim të fitimeve politike, por, po ashtu, edhe për të fituar kapital simbolik. Dhe, do të thosha, gjithashtu, edhe për ta bërë rrugën e tyre drejt BE-së më të lehtë, duke e imituar këtë aspekt të kujtesës evropiane.

Unë do të ndalem këtu, sepse përndryshe biseda bëhet vërtet, me të vërtetë e gjatë, por nëse ka ndonjë pyetje më pastaj, unë do të isha shumë e lumtur t'iu përgjigjesha pyetjeve, mbase duke parë në mënyrë specifike një rast të caktuar ose një vend të caktuar, ose një aspekt të këtij procesi.

Vjollca Krasniqi

Faleminderit shumë, Ana. Është e rëndësishme, mbase më vonë, të dekonstruktohen pak më shumë dinamika dhe modelet e atyre pikëpamjeve të thjeshta për të kaluarën dhe që, gjithashtu, të shihet se si dhe në çfarë mënyre janë përbartur normat e kujtesës të BE-së në kontekstin e Evropës Juglindore, veçanërisht në Serbi, në Kosovë dhe në Kroaci. Faleminderit dhe ne do të kthehemi me pyetje më vonë. Vjerran, fjala është e jotja.

Vjerran Pavllaković

Faleminderit Vjollca, faleminderit që më ftove. Është madhështore të jesh në një panel kaq të nderuar me disa miq të mirë. Kjo është një temë e rëndësishme, është një temë e madhe, për të cilën ju na keni dhënë shumë material për të punuar. Megjithatë unë kam bërë prezantime mbi politikën e kujtesës në Evropën Juglindore shumë herë në të kaluarën,

pyetjet tuaja më kanë frymëzuar për disa meditime të reja mbi këtë temë, veçanërisht në dritën e pandemisë globale këtë vit.

Më lejoni të filloj me një imazh të përkujtimit të këtij viti në Kampin e Përqendrimit në Jasenovc, me vendndodhje në Kroaci. Pas disa vitesh të ndarjes, këtë prill u mbajt një përkujtim i vetëm. Dukej se, pavarësisht situatës me Covid-19, kultura e përkujtimit e Kroacisë po kthehej në normalitet. Por, në të vërtetë, shumë shpejt pasi u bë kjo fotografi, tashmë kishte një ndarje midis udhëheqjes politike në Kroaci. Presidenti Zoran Millanoviç nuk mund t'i rezistonte lëshimit të deklaratave për shtypin rreth mendimit të tij mbi një monument që përmbante përshëndetjen kontraverze të Ustashëve, "Për Atdheun - gati!" (Za dom spremni) që u hoq nga Jasenovci në vitin 2017, duke shkaktuar disa javë debate të përsëritura rreth simboleve, monumenteve dhe kujtesës së Luftës së Pavarësisë të Kroacisë. Në këtë prezantim, unë do të jap një përmbledhje të shpejtë të politikës së kujtesës në Evropën Juglindore (me një fokus në Kroacinë), një reflektim mbi trendet e fundit dhe ndikimin e aktivizmit të kujtesës dhe do të përfundoj me disa nga ndryshimet kryesore që kanë ndodhur këtë vit.

IMAZHI 1: Përkujtimi në Jasenovc më datën 22 prill të vitit 2020.



Burimi: <https://www.jutarnji.hr/vijesti/hrvatska/drzavni-vrh-i-predstavnicizrtava-u-jasenovcu-kraus-dosao-sam-pruziti-ruku-i-dobru-volju-ali-sljedecegodine-necu-doci-ako-se-nista-ne-promijeni-10234540>

Unë me vite kam ndjekur shumë nga këto përkujtime, si për Luftën e Dytë Botërore, ashtu edhe për Luftën Kroate të Pavarësisë, ose Luftën Atdhetare (*Domovinski rat*) siç quhet këtu. Projekti im “Kornizimi i kombit dhe kujtesa kolektive në Kroaci” (FRAMNAT) ka analizuar pesë përkujtime të Luftës së Dytë Botërore dhe dy për luftën e viteve të 1990-ta. Ekipi im humltues (Davor Pauković, Benedikt Perak, Tamara Banjeglav dhe Renato Stanković) ka vënë re se si në narrativat e institucionalizuara ashtu edhe në politikat e përkujtimit nga poshtë-lartë, kanë qenë të ndërthurura Lufta e Dytë Botërore, trashëgimia e komunizmit, dhe luftërat e viteve të 1990-ta. Mendoj se ky është rasti për pothuajse të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë në nivele të ndryshme.

Unë mendoj se kjo ndërthurje e këtyre tre narrativave është veçanërisht e fortë në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë. Përmes monumenteve, përkujtimeve dhe kulturës popullore është e mundur të shihet se si ato gërshetohen në mes tyre. Cilat janë disa nga aspektet e kësaj kulture të kujtesës? Ka një trashëgimi kujtimesh të heshtura dhe të shtypura që nga viti 1945, përveç rrëfimeve zyrtare. Jo vetëm të Luftës së Dytë Botërore, por edhe të asaj se çfarë ka ndodhur gjatë regjimit komunist si dhe në vendet e reja të pas viteve të 1990-ta. Ekziston një trend rajonal i ngurrimit për të diskutuar hapur për të gjitha aspektet e ngjarjeve traumatike të shekullit të XX.

Nuk është për t’u habitur që secili shtet dhe secili regjim ka kërkuar të imponojë narrativën e tij mbizotërues dhe kjo reflektohet në hapësirën publike përmes programeve arsimore, përmes diskursit politik, kulturës popullore, etj. Për më tepër, unë mendoj se këto luftëra, ngaqë ato shërbejnë si ngjarje themelore të ndërtimit të shtetit, qoftë në Jugosllavinë socialiste, qoftë në vendet e pavarura post-jugosllave, janë të mbarsura me një shenjtëri që pasqyrohet në përkujtimin e tyre. Së këndejmi, bëhet shumë e vështirë t’i sfidosh këto në një mënyrë të hapur demokratike dhe pluraliste. Më në fund, ekziston një mjegullim i këtyre periudhave të veçanta historike në një rrëfim kombëtar. Çfarë ndodhi me kroatët ose Kroacinë në vitin 1945, mund ta shohim që rikthehet përsëri në vitet e 1990-ta, të paktën në narrativën zyrtar.

Një aspekt tjetër i këtij mjegullimi të së kaluarës - ose, më konkretisht, turbullira e të kaluarave të shumëfishta - është nacionalizimi i rrëfimeve. Për shembull, Lufta e Dytë Botërore nuk ka të bëjë më me një lëvizje rezistente pan-jugosllave, por, përkundrazi, me interpretime kombëtare kroate ose serbe ose sllovene të saj. Një shembull të kësaj e kemi vënë re gjatë punës sonë në terren në përkujtimin në Knin të Operacionit Stuhia, i cili krem-

ton çlirimin e territorit të pushtuar të Ushtrisë Kroate në vitin 1995. Përveç shumë suvenireve dhe bluzave, që kishin të bënin me Luftën Atdhetare, në atë kremtim kishte shumë simbole të ustashëve, këmisha të lidhura me “Bleiburg-un” dhe referenca të tjera të Luftës së Dytë Botërore, që është një përdorim interesant dhe disi shqetësues i këtyre imazheve dhe simboleve.

IMAZHI 2: Shtandi i suvenireve në Knin, ku shiteshin bluza për të përkujtuar operacionin Stuhia, Bleiburg-un dhe Shtetin e Pavarur të Kroacisë (NDH), 5 gusht 2016.



Autor: Vjerran Pavllaković

Ne e kemi vënë re këtë në shumë raste gjatë punës sonë në terren. Si pasojë, mendoj se është e rëndësishme të identifikohen aktorët mnemonikë dhe sipërmarrësit e kujtesës, të cilët e drejtojnë politikën e kujtesës në Evropën Juglindore më gjerësisht, dhe në Kroaci në mënyrë më specifike.

Një fotografi nga përkujtimi i Ditës së Luftës Antifashiste në Malin e Brezovicës në vitin 2015 e përshkruan një spektër vërtet të gjerë të këtyre aktorëve mnemonikë të mbledhur në një vend. Ka qenë hera e fundit që

ish presidentja, Kolinda Grabar-Kitarović, kishte shkuar në këtë përkujtimore. Por, grupe të ndryshme politike po i përdornin përkujtimet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe fjalimet e tyre përkujtimore; dhe kjo ishte një nga aspektet në të cilën jemi përqendruar, për të parë se si politikanë të ndryshëm dhe elita politike i kanë përdorur praktikën përkujtimore. Kolegu im Benedict Perak, një studiues i gjuhësisë kognitive, ka analizuar se si politikanë dhe aktorë të tjerë kryesorë shoqërorë i përdorin fjalët kur flasin për të kaluarën dhe ata mund të grupohen në bashkësit aktuale të përkujtimit. Aktorë të ndryshëm politik kanë folur në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme. Kjo është një mënyrë interesante për të parë se si ndërtohet kujtesa, sepse, përgjithësisht, individë të veçantë nuk do të marrin pjesë në përkujtime të shumta. Zakonisht ata shkojnë në përkujtimin që është ideologjikisht më i afërt me ta ose i lidhur drejtpërdrejt me ndonjë traumë familjare. Janë vetëm disa studiues paksa të “çmendur” që marrin pjesë në të gjitha këto përkujtime.

IMAZHI 3: Udhëheqja politike kroate mbledhet në Malin e Brezovicës për Përkujtimin e Ditës së Luftës Antifashiste, 22 qershor 2015.



Autor: Vjeran Pavlaković

Dhe, atëherë, kush janë pjesëmarrësit? Sepse po vëzhgojmë gjithashtu se si këto narrativa të ndryshme janë transmetuar në shoqëri. Kush ishin njerëzit që kishin marrë pjesë në këto përkujtime? Ka nga të gjitha llojet e njerëzve që marrin pjesë në ngjarje përkujtimore, pjesëmarrja e shumë prej të cilave është organizuar nga komunitetet fetare, organizatat e veteranëve,

shoqatat e viktimave ose delegacionet zyrtare. Duhet bërë më shumë hulumtime në lidhje me motivimin për të marrë pjesë në ngjarje përkujtimore. Një trend, të cilin e kemi vërejtur nga viti 2014 e deri në vitin 2018 në përkujtimet kroate ishte përçarja. Gjatë pesë viteve të kaluara, pothuajse çdo përkujtim që e kemi vëzhguar është ndërprerë në një farë mënyre, pavarësisht nëse ishin përkujtimet e shumta në Jasenovc, protestat në Srb (për Ditën e Kryengritjes), kundër-përkujtimet gjatë Ditës së Luftës Antifashiste, apo procesionet rivale përkujtimore në Vukovar.

Si Lufta e Dytë Botërore, ashtu edhe luftërat e viteve 1990-të, mbesin të politizuara dhe polemizuese. Ky imazh i dy kuratorëve muzeal, njëri nga faqja zyrtare e Memorialit në Jasenovac (në Kroaci) dhe tjetri nga Donja Gradina (në Republika Srpska, Bosnjë-Hercegovinë), duke vështuar njëri-tjetrin me numrat e kontestuar të viktimave të Jasenovac pas tyre, ilustron se si ndikojnë interpretimet rrënjësisht të ndryshme të së kaluarës në marrëdhëniet dypalëshe jo vetëm në shtetet, por edhe, siç supozohet, në institucionet neutrale shkencore. Secili institucion përpaket të argumentojë se interpretimi i tij është i vërteti, dhe kur përfshihen projekte ose aktorë ndërkombëtarë, ka narrativa shtesë që duhet marrë në konsideratë. Kjo bëhet veçanërisht problematike kur këto çështje kanë përparësi kundruall zgjidhjes së çështjeve praktike ose shqetësimeve ekonomike për qytetarët e këtyre vendeve.

IMAZHI 4: Pllaka të diskutueshme në lidhje me numrin e pretenduar të viktimave të Kampit të Përqendrimit në Jasenovc në vendin përkujtimor Donja Gradina në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2018.



Autor: Vjerran Pavllaković

Meqenëse, në realitet, një numër shumë i vogël i qytetarëve marrin pjesë në këto përkujtime, mediet luajnë rol të rëndësishëm në transmetimin e politikës së kujtesës. Prandaj, studiuesit e FRAMNAT, përveç punës së gjerë në terren, kanë ndjekur nga afër mbulimin mediatik të të gjitha përkujtimeve. Ne ishim të interesuar për atë që kishin raportuar mediet, çfarë lloj imazhesh ata kishin zgjedhur për të botuar dhe çfarë lloje të titujve ishin vendosur në faqet e para. Ne kemi ndjekur mediet e shkruara dhe ato elektronike dhe ishte interesante të krahasohej ajo që ne e kishim parë në përkujtimet aktuale me atë që shihet në shkrimet e gazetarëve. Ndërsa nuk kishte raste të ndonjë shtrembërimi të qartë, llogaritë e pjesshme kanë treguar se është thelbësore për të kryer punën në terren me qëllim që të kuptohet plotësisht se si funksionon politika e kujtesës.

Monumentet janë një aspekt tjetër i rëndësishëm i transmetimit të kujtesës. Unë nuk do t'ju tregoj tetë milion imazhe të monumenteve, por këto që unë do t'ua tregoj janë të gjitha nga vendet ish-jugosllave që janë marrë me ndërtimin e shtetit. Disa janë më abstrakte se të tjerët dhe, edhe pse procesi ndryshon nga vendi në vend, ka tendenca të ngjashme të fshirjes, të vandalizimit, të transformimit ose të shkatërrimit të një rrëfimi të së kaluarës dhe të zëvendësimit të tij me një seri të re të memorialëve dhe të narrativave. Kjo nuk lidhet vetëm me konfliktet e viteve 1990-ta, por, gjithashtu, përfshin edhe ri-interpretimet e Luftës së Dytë Botërore. Ka shumë shembuj me karakteristika të dyshimta estetike, si dhe simbole të diskutueshme, që ndodhen në hapësirën publike. Ndonjëherë çështja është se çfarë të bëhet me simbolet nga regjimi komunist ose me përpjekjet për të instaluar simbole të reja që duken fare qartazi se aludojnë në fashizëm ose në ideologji të tjera problematike. Ka shumë raste kur monumentet lëvizin në vende të reja.

Një nga shembujt më të fundit të monumenteve në lëvizje ishte pllaka përkujtimore e diskutueshme e përmendur nga Presidenti Millanović pas përkujtimit të Jasenovcit. Kushtuar ushtarëve të HOS-it, të cilët vdiqën në vitet 1990-ta, memoriali përfshinte parullën e ustashëve *Për atdheun të gatshëm* (Za dom spremni) dhe është ngritur në vitin 2015 në fshatin Jasenovc, afër vendit përkujtimor të kampit të përqendrimit ku dhjetëra mijëra njerëz janë vrarë nga regjimi që e përdori atë parullë. Kjo pllakë përkujtimore ishte një nga arsyet e përkujtimit të ndarë të Jasenovcit. Kompromisi ishte për ta zhvendosur atë 20 kilometra më tutje në një vend tjetër afër qytetit Novska, por ai vend kishte dikur një monument partizan. Ishte një vend i vendosjes së eshtrave, i cili më pas u shkatërrua gjatë luftës në vitet 1990-ta. Zgjidhja për t'u marrë me të gjitha këto shtresa të

Slobodna Dalmacija
HRISTINA, 14. 5. 2019.



2

Poljani su se
ravnali prema
hrvatsko zastavi,
dizali su se s
kole, kretali, ali
su se odmah
zadržali.

[illegible]

● Ceremoniji prisjećanja na 74. obljetnicu masakra Hrvata na Bleiburgu nazočilo je ove godine više od deset tisuća građana koji su pristigli iz svih dijelova Hrvatske, a samo jedan pozdravio je nacističkim pozdravom te je ekspresno uhićen. Skup je nadziralo 500 policajaca

TOMISLAW KURIC
 Associate Professor of English Literature

Jedan je analitičar, koji je došao iz Nj, na kraju skupa političke elite u austrijskoj policiji, te je upoznao s obitelji u Eisenstadt pa je otkrio da u Klagenfurt na zapadne Alpe. A otkriveni prijatelji su 24. oktobra masakra čitavo na Eisenstadt napadali i sve godine više od deset tisuća ljudi smatrali koji su pristigli iz svih dijelova Hrvatske. Čak i tada je počela analitičar u hrvatskom grad u Eisenstadt, koji je tada se preselio pred vojnom reformom opstati prvo poći na krst, je tako je tako je tako.

muscle activity

It specialising vendors enable us to have a specialist in each of the various areas of the business and to have a specialist in each of the various areas of the business and to have a specialist in each of the various areas of the business.

Uprkos činjenici da su u ovom slučaju i te mikrofite, ali i gotovo 500 godišnjicu kraljeve kraljevine, u skladu s 12. člankom iz Hrvatske, odmah se može dogoditi da se...

PROSVED RASNOČE FRONTY

Jugoslavenska zastava na traktoru

Učeli skupa u centru Bile odriše je jedan od dvije najavljenih pravljeda po komemoracije na štitu polju, ne unatoč napetosti i je pacifi relativno u Pedesetak pravljednika razlomiti članova Hrvatske izmice, razvili je transp "između i dječak, zajedno sli i dječak", a na jedan traktor postavili su

jugoslavenskoj zastavi. Odlučivao ih je veliki broj pešaka. Samo u jednom trenutku došlo je do komešanja jer su, druge strane željezničke pruge, našli sudionici komunističkog špija. U početku prepućavanje austrijske policije koje ih je ušla na ne daleko od njih. U slučaju

U viert, het meisje

[illegible][illegible]

shumta të kujtesës ishte thjesht zhvendosja e monumenteve, pa adresuar me të vërtetë çështjen në lidhje me përdorimin e simboleve në Kroaci. Komenti i Presidentit Millanoviq ishte se pllaka e diskutueshme përkujtimore duhej të hidhej në mbeturina, e cila - jo për çudi - zemëroi shumë veteranë të Luftës Atdhetare dhe thjesht e forcoi vendosmërinë e tyre për të vazhduar përdorimin e simboleve të diskutueshme. Në vitin 2016, Kryeministri Andrej Plenković krijoi një komision të dedikuar për trajtimin e simboleve të regjimeve jodemokratike, i cili kishte arritur në përfundimin se simbolet e ustashëve dhe *Për Atdheun të gatshëm* (Za dom spremni) ishin antikushtetuese. Sidoqoftë, qëndrimi i komisionit ishte paradoksal në lidhje me faktin se ai deklaroi njëkohësisht se simbolet lejoheshin në disa ngjarje përkujtimore, megjithëse nuk ishte specifikuar asnjëherë se në cilin vend. Në fund të fundit, problemi është se Kroacia kurrë nuk e ka përcaktuar plotësisht në mënyrë ligjore atë se çka përbën një simbol të ustashëve ose të fashistëve, duke e bërë gati të pamundur sanksionimin efektiv të përdorimit të tyre. Për më tepër, kjo është një çështje interesante në lidhje me përkujtimin e “Bleiburg-ut”, ku nga policia austriake pritet të zbatojë një ndalim të simboleve fashiste, megjithatë nuk është gjithashtu e qartë se cilat simbole hyjnë në këtë kategori.

IMAZHI 6: Novska: Vend jashtë Novska, ku pllaka e diskutueshme përkujtimore *Për Atdheun të gatshëm* (Za dom spremni) është zhvendosur në vitin 2017.



Autor: Vjerran Pavllaković

IMAZHI 7: Policia e Bleiburg-ut. Individë të veshur me uniforma të ustashëve, që shfaqnin një flamur të ustashëve pranë policisë austriake në përkujtimin e Bleiburg-ut në muajin maj të vitit 2009.



Autor: Vjerran Pavllaković

Pyetja e dytë e Vjollcës lidhet me tendencat e fundit në politikën e kujtesës në Evropën Juglindore. Në të gjithë rajonin, shtetet kanë përdorur përkujtime për të kornizuar narrativat mbizotëruese të shtetndërtimit, narrativa të cilat kanë qenë gjithmonë të ndikuara nga grupi politik në pushtet. Në Kroaci, për shembull, administratat e krahut të djathtë ose të majtë janë përqendruar në Bleiburg ose Jasenovc, si narrativa kryesore të Luftës së Dytë Botërore. Ka interpretime të reja kombëtare apo edhe nacionaliste në të gjithë rajonin. Millanović, në kohën sa ishte kryeministër, ka theksuar pjesëmarrjen kroate në lëvizjen partizane gjatë përkujtimeve në Jasenovc, ndërsa në Bleiburg, politikanët kanë pretenduar në fjalimet përkujtimore se regjimi i ustashëve kishte luftuar thjesht për një shtet të pavarur Kroat. Për më tepër, këto praktika përkujtimore dhe kulturat përkujtimore janë të ndara jo vetëm në rrafsh ideologjik, por edhe në atë etnik - me fjalë të tjera, lidhur me atë se kush shkon dhe merr pjesë në ato përkujtime. Unë jam përqendruar kryesisht në aspektin lartë-poshtë këtu, por ka shumë nisma të kujtesës nga poshtë-lartë, duke përfshirë këtu edhe ndërmarrësit e memories jo-shtetërore, që i përmenda më parë: shoqatat e veteranëve, grupet e vikti-

mave, organizatat joqeveritare (OJQ-të), madje edhe njerëzit që shesin suvenire në raste të përkujtimeve të ndryshme.

Imazhet nga Bleiburgu në vitin 2017 i tregojnë të gjitha mjetet që janë në shitje, të cilat nuk kanë të bëjnë me përkujtimin e viktimave dhe, përkundrazi, janë drejtuar për të glorifikuar regjimin e ustashëve dhe simbolet e tyre. Unë, madje, nuk e tregova standin e sallamit dhe birrën që po shitej atje. Austria, që atëherë, e ka ndaluar këtë lloj të sjelljes, kështu që kjo duket se tashmë i përket së kaluarës. Sigurisht, për shkak të pandemisë së Koronës, ky përkujtim nuk është zhvilluar me një publik fare këtë vit, por ky aspekt i përkujtimeve tregon se po zhvillohet një biznes i tërë i kujtesës. Ndoshta një projekt i ardhshëm do të shqyrtojë në mënyrë më sistematike financimin e monumenteve, organizimin e përkujtimeve, shitjen e suvenirëve etj.

IMAZHI 8: Suvenire me simbole dhe ushtarë ustashë për shitje në përkujtimin e Bleiburg-ut në muajin maj të vitit 2017.



Autor: Vjerran Pavllakoviç

Së fundmi, aspekti i tretë që Vjollca na e kërkoi që ta diskutojmë ka të bëjë me OJQ-të dhe me aktivizmin e kujtesës. Në një farë mënyre, ato janë, gjithashtu, sipërmarrëse të kujtesës, por, ndoshta ngaqë jam i përfshirë me shumë prej këtyre grupeve dhe kam udhëhequr shumë ekskursione

të kujtesës, unë prirem t'i shikoj ato në mënyrë më të favorshme dhe pozitive. Sidoqoftë, mendoj se shkencërisht duhet të jemi objektivë kur analizojmë rolin e tyre. Por, për Kroacinë, unë mendoj dhe besoj se aktivizmi i kujtesës shërben si një rol pozitiv dhe ai ka krijuar një hapësirë publike për të diskutuar traumat e së kaluarës për grupe, të cilat janë marginalizuar, harruar, shtypur ose heshtur. Aktivizmi i OJQ-ve në Kroaci, po ashtu, ka tërhequr vëmendjen në vendet e harruara të kujtesës, të tilla si “Goli Otok”, ku i kam dërguar studentët disa vjet më parë. OJQ-ja Documenta ka punuar gjerësisht për të krijuar një vend të duhur të kujtesës në “Goli Otok”, i cili është një simbol i shtypjes komuniste, por që në fakt ishte drejtuar kryesisht kundër komunistëve jo-Kroatë pas ndarjes së Tito-Stalinit dhe kështu nuk është ideale as për krahun e djathtë e as atë të majtë. Qyteti i Vukovarit, i dëmtuar rëndë në Luftën e Pavarësisë të Kroacisë, është një vend tjetër ku ka shumë punë kujtese nga lartë-poshtë nga shteti, por gjithashtu një vend ku organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare punojnë në përpjekjet për pajtim në terren.

IMAZHI 9: Mbetjet e një kompleksi të burgut në Goli Otok, 2014.



Autor: Vjeran Pavllaković

IMAZHI 10: Një vizitë studimore në Qendrën Përkujtimore për Luftën e Atdheut, Vukovar, në Shtator 2018.



Autor: Vjeran Pavllaković

Kjo ka përfshirë organizimin e shumë punëtorive, shkollave verore, tryezave të rrumbullakëta dhe aktiviteteve të tjera drejtuar të rinjve. Kjo është një qasje pozitive dhe e rëndësishme, pasi studentët dhe të rinjtë, në përgjithësi, dinë shumë pak për të kaluarën e afërt dhe janë të prirë të përsërisin tragjeditë e viteve 1990-të nëse nuk janë të pajisur me aftësitë e të menduarit kritik të nevojshëm për të parandaluar ngritjen e një klime politike populliste, ksenofobike dhe jotolerante. Për më tepër, OJQ-të mund të përdorin punën e kujtesës për të ndihmuar krijimin e një brezi të ri, i cili politikisht është i shkolluar dhe i interesuar për të kuptuar të kaluarën e afërt, pasi një gatishmëri më e madhe prej tyre për t'u angazhuar do të thotë se ka më pak gjasa të manipulohen nga shteti. Si përfundim, pavarësisht nga këto ndarje, problemet dhe instrumentalizimet politike, mendoj se kishte një ndryshim në kulturën përkujtimore kroate këtë verë. Megjithatë ka mjaft cinizëm dhe skepticizëm në lidhje me potencialin e përkujtimeve për pajtim, megjithëkëtë, mendoj se përpjekja për krijimin e një kulture përkujtimore më gjithëpërfshirëse ishte një moment i rëndësishëm simbolik njëzet e pesë vjet pas konfliktit të viteve 1990-të.

Këtë gusht, në përkujtimin e Operacionit Stuhia në Knin, udhëheqjes politike kroate i është bashkuar për herë të parë një përfaqësues i partisë kryesore serbe në Kroaci, Boris Millosheviq, i Partisë së Pavarur Demokratike Serbe (SDSS). Megjithëse disa serbë të Kroacisë kanë menduar se ky akt e kishte zvogëluar njohjen e vuajtjeve serbe gjatë luftës së viteve 1990-të, të cilës i kishte bërë jehonë qeveria serbe e Aleksandar Vuçiqit, presidenti kroat, kryeministri dhe kryetari i parlamentit, që të gjithë kanë lëshuar mesazhe pajtuese që përqendroheshin në të ardhmen. Kjo ngjarje historike përkujtimore është pasuar nga pjesëmarrja e Ministrit për Çështje të Veteranëve (Tomo Medved) dhe Presidentit Millanoviç në një përkujtim në Grubori, si dhe të Kryeministrit Plenkoviç në Varivode, dy fshatra ku trupat kroate kanë kryer krime të luftës kundër civilëve serbë. Këto ishin hapa pozitivë simbolikë përpara, të cilët duhet të plotësohen me përpjekje konkrete socio-ekonomike për të përmirësuar jetën e të kthyerve serbë në Kroaci dhe, më gjerë, me nisma për krijimin e një shoqërie tolerante për të gjithë qytetarët e Kroacisë.

IMAZHI 11: Procesioni i Kujtimit të Vukovarit dhe kulla e ujit të Vukovarit, 18 nëntor, 2014.

Autor: Vjerran Pavllakoviç



Sllajdi im i fundit paraqet një imazh të përkujtimit të ardhshëm në Vukovar, i cili gjithashtu ka potencialin për pajtim të mëtejshëm simbolik. Është një mundësi tjetër për të njohur faktin që viktimat e palës “Tjetër” ishin gjithashtu viktima, veçanërisht viktimat civile, që nuk do të thotë të barazosh agresorët dhe viktimat në narrativin e përgjithshëm të luftës. Ajo që e bën ose efekti është që të krijojë një atmosferë për të ndjekur një dialog, duke i lejuar familjet që i kanë humbur njerëz e tyre të dashur që të kujtojnë ata në një mënyrë dinjitoze dhe që të sugjerojë që të mos përdorin këto politika përkujtimore, këto politika të kujtesës, vetëm për agjendat nacionaliste të aktorëve të ndryshëm politikë.

Vjollca Krasniqi

Po, faleminderit, Vjeran për ofrimin e këtij vështrimi të hollësishëm të temës së panelit. Është shumë e rëndësishme të ndërtohet një arkiv i të gjitha praktikave të përkujtimit; për të reflektuar mbi ndryshimet, mbi drejtimet e reja dhe ato që priten në të ardhmen. Faleminderit shumë, Vjeran, edhe unë kam pyetje, dhe, gjithashtu, të ftuarit tanë në panel mund të kenë pyetjet e tyre, po ashtu. Faleminderit edhe një herë.

Tani, unë do të doja t’ia jepja fjalën Naum Trajanovskit.

Naum Trajanovski

Faleminderit Vjollca. Shpresoj se po më dëgjon?

Vjollca Krasniqi

Po, po ju dëgjoj.

Naum Trajanovski

Ka qenë një periudhë me plot ngjarje për marrëdhëniet bullgaro-maqedonase. Ajo që ka filluar me të ashtuquajturin Memorandum Shpjegues Bullgar në mes të muajit shtator të vitit 2020 - një letër e qëndrimeve me gjashtë faqe nga Asambleja Kombëtare Bullgare - ka përfunduar me një grindje të ashpër ndër-kombëtare mbi disa simbole kombëtare të pretenduara nga bullgarët dhe nga maqedonasit dhe, përfundimisht, me një bllokim bullgar për fillimin zyrtar të negociatave të Maqedonisë

së Veriut për BE në datën 17 nëntor të vitit 2020. Kornizat e ndryshme interpretojnë mbi historinë dhe çështjet e lidhura me kujtesën duken të larguara më shumë se kurrë në historinë bashkëkohore dhe, rrjedhimisht, me të ardhmen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në një rrezik të lartë. Kohët e fundit, kështu, pozicionet e të dyja shteteve i ngjajnë një lakoreje asimptote dhe një konkave. Kalimet duhet të llogariten përsëri.

Unë do të përpiqem të kontekstualizoj grindjen bullgare-maqedonase të historisë më të re dhe të kujtesës duke e sjellë në tryezë zgjidhjen Greko-Maqedonase të vitit 2017. Sipas Valérie Rosouxit, ekzistojnë dy qasje mbizotëruese të BE-së për pajtimin historik ndërshtetëror në dy dhjetëshe të fundit - ajo “minimaliste”, e cila e lejon ekzistencën e dy (ose më shumë) tregimeve paralele historike dhe të kujtesës, dhe ajo “maksimaliste”, e cila e ndjek një proces mjaft transcendent, “shumë më kërkues, që e kërkon të vërtetën, drejtësinë dhe faljen”.

Në çështjen Greko-Maqedonase, e ashtuquajtura Marrëveshje e Prespës e muajit qershor të vitit 2018 i ka karakterizuar si maksimalistët (monumentet publike që përshkruajnë historinë antike në Maqedoninë e Veriut), ashtu edhe fushat minimaliste (nënshkruesi i “Maqedonisë” dhe “Maqedonas” si në Maqedoninë e Veriut dhe Greqi). Në çështjen Bullgaro-Maqedonase, Traktati i Miqësisë i muajit gusht të vitit 2017 e ka përcaktuar fushën maksimaliste si një grup përkujtimesh shtetërore publike të figurave historike dhe të ngjarjeve të nderuara në të dy shtetet; dhe domeni minimalist: siç vihet re në Traktat, “respekt reciprok, besim, mirëkuptim, fqinjësi e mirë dhe respekt i ndërsjellë për interesat” e të dy shteteve. Menjëherë pas nënshkrimit të traktatit, Zoran Zaev, Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, ka pohuar se dokumenti “nuk do të dëmtonte ose minonte Maqedoninë në asnjë mënyrë”, por do ta bënte Bullgarinë “më të përkushtuar ndaj miqësisë”. Ajo që duket se po shpallet pas vetos së muajit nëntor është një riorganizim strategjik në këto aspekte: një përpjekje për të ripërcaktuar domenin shumë minimalist në Bilateralizmi Bullgaro-Maqedonas. Siç thuhet në Traktat, “respekt reciprok, besim, mirëkuptim, fqinjësi e mirë dhe respekt i ndërsjellë për interesat” e të dy shteteve.

Këtu, një paralele tjetër me zgjidhjen greko-maqedonase na del para duarsh. Edhe pse shumë vëzhgues të marrëdhënieve bullgaro-maqedonase kanë gjurmuar me saktësi kontestet ndërshtetërore deri në fund të viteve 1960-të, disa zyrtarë të lartë bullgarë e kanë ngritur tonin dhe kanë filluar të lëkundën nga një pengesë tjetër për integritet e Maqedonisë së

Veriut në BE vetëm pas Marrëveshjes së Prespës (në vitin 2012, Bullgaria, së bashku me Greqinë, e kanë bllokuar rrugën e Maqedonisë së Veriut për në BE - një episod ky i cili rrallë shfaqet në debatet maqedonase). Kjo manovër është kryer - midis masave të tjera - nga një zhvendosje diskursive në fushat simbolike të “historisë me të përbashkëta” - sipas Traktatit - në një “histori të përbashkët” dhe, më pas, “të vlerave evropiane” të Traktatit të Miqësisë. Aktivizmi i kujtesës së krahut të djathtë përtej kufijve shtetërorë që nga fillimi i viteve 2000 është një nga shembujt më të spikatur këtu, pasi këto grupe bashkëpunuese kanë arritur jo vetëm të sjellin figura të caktuara historike në ballë të debateve publike, por edhe të ngarkojnë diskursin publik mbi një histori “të përbashkët» ose «tonën” me këto kërkesa të veçanta. Historia e gjatë e dy dekadave e përkujtimit të Mara Bunevës në Shkup, si dhe bashkëpunëtorët e tjerë të luftës së djathtë të VMRO-së, flasin gjithashtu në lidhje me këto.

Ky shënim i shkurtër mund të shërbejë si një tregues i debatit të tanishëm mbi nivelin e ndikimit politik të nocionit “etnogjenezë” - frazë e re, pas nëntorit, e marrëdhënieve bullgaro-maqedonase. Në teori, nuk ka një konsensus uniform, një dimensional dhe gjithëpërfshirës për qëllimin dhe kuptimin e tij, përkundrazi, ai i nënshtrohet koncesioneve shoqërore dhe politike. Njohuritë kritike nxjerrin në pah agjencinë e historianëve si fokale për procesin e, po shprehem me fjalët e Wim van Meurs, një ndarjeje jokritike të “historisë botërore në narrativa madhështore, jo të ngatërruara për pjesën më të madhe të shekullit XX”. Shprehja e zakonshme e “lënies së historisë historianit” është pra një tjetër figurë e cila, ngjashëm me nocionet e historisë “e zakonshme” ose “e përbashkët” dhe “vlerat evropiane”, duhet të trajtohet me kujdes në lidhje me mosmarrëveshjen Bullgaro-Maqedone lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me historinë dhe me kujtesën. Ndarjet e njohura politike janë të gjalla dhe dërmuese në sferën e shkrimit të historisë (nuk është e nevojshme të thuhet, si në Bullgari ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut), dhe koncepti i etnogjenezës është një nga pikat më theksuara të këtyre ndarjeve.

Një hartë e përafërt do të tërhiqej përgjatë këtij boshti: Ekspertët që ndërtojnë mbi narrativat ekskluziviste të etnogjenezës në qendër të kombit dhe grupi tjetër i ekspertëve që synojnë të shkojnë përtej kësaj paradigme. Duke qenë një çështje jo-afatgjatë në historiografinë bullgare post-komuniste, Maqedonia dhe historia e saj janë komentuar kryesisht nga studiues të lidhur me Institutin Shkencor Maqedonas të rihapur në Sofje - sipas Tchavdar Marinov, një institucion “i etur për të mbështetur çdo përpjekje revizioniste” në Maqedoninë e Veriut “si një hap drejt

(ri) Bullgarizimit të Maqedonisë, si një premtim i «kthimit në rrënjët bullgare» - prandaj marrja e saj kryesisht antimoderniste e ndërtimit të kombit maqedonas (e cila mund të gjurmohet në grupet e djathta brenda Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase ndërluftuese). Disa aspekte të këtij pozicioni janë, rastësisht mjaftueshëm, aktualisht duke u rikrijuar si një politikë shtetërore - bullgare ndaj Maqedonisë së Veriut. Ajo që e dallon grupin tjetër të historianëve është, le të flasim në mënyrë të përafërt, miratimi i debateve të sotme shkencore mbi solidaritetin kombëtar në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, ndërturjet ndërkuftare, lidhjet transnacionale dhe transferimi i njohurive. Duhet kërkuar nënshkruesit e dy letrave të hapura si reagim ndaj Memorandumit Bullgar dhe vetos bullgare, emrat e atyre ekspertëve. Për më tepër, e panjohur për publikun e gjerë në Maqedoninë e Veriut, Qendra për Studime të Avancuara me qendër në Sofje është një institucion i tillë që kontribuon jashtëzakonisht në një historiografi të de-esencializuar për rajonin dhe më gjerë.

Megjithëkëtë, çështja kryesore mbetet një çështje e përgjithshme - të dyja grupet e historianëve rrallë e lexojnë dhe dëgjojnë njëri-tjetrin. Një analizë e hollësishme, madje, do të zbulojë platforma të ndryshme të botimeve dhe të rrjeteve të ndryshme të vlerësimit nga kolegët - si nga aspekti i gjuhës (anglisht, gjermanisht, madje frëngjisht, bullgarisht dhe maqedonisht) si dhe audiencës (ndërkombëtare përkundër asaj kombëtare). Megjithatë - ashtu kundërintuitive siç mund të duket - çelësi i historisë së sotme bilaterale- dhe mosmarrëveshjes së kujtesës, është që të përshtatim të gjitha këto pretendime (të rëndësishme dhe divergjente) të palëve të interesuara. Në lidhje me këto, një përpjekje politike e tipit ideal do të ishte krijimi i një platforme neutrale gjithëpërfshirëse për një debat kritik, kornizë konceptuale dhe për një strukturë operacionale. Përhapja e nocioneve kritike në domenin publik, politizimi i tyre i pafund dhe, së fundmi, ri-legjitimimi nga aktorë dhe agjentë të ndryshëm, është një nga dobësitë kryesore të mungesës së një platforme të tillë.

Me fjalë të tjera, një izomorfizëm normativ, siç janë modelet shumë të thirrura evropiane të komisioneve të historisë, duket se është zgjidhja më racionale. Një ilustrim përfundimtar: në vazhden e debateve të komisionit të historisë polako-gjermane nga vitet 1970-të dhe 1980-të dhe veçanërisht pas finalizimit polak të procesit të pranimit në BE në muajin maj të vitit 2004, janë krijuar disa institute ndërshtetërore dhe trans-evropiane me qëllim të ushqimit të kompromiseve të arritura nga komi-

sioni dhe, siç e ka thënë Robert Traba, të neutralizimit të tendencës për (ri) keqpërdorim të tropeve të historisë dhe tropeve të kujtesës nga elitat politike. Projekti ndërdisiplinar pesë-vjeçar i drejtuar nga Qendra për Kërkime Historike të Akademisë së Shkencave Polake në Berlin, me titull “Mbretëritë Polako-Gjermane të Kujtesës”, është një shembull i tillë, i cili përveç idesë ambicioze të “shikimit të marrëdhënieve Polako-Gjermane nga një perspektivë e re”, ka synuar “lidhjen e kërkimit mbi kulturat e kujtesës me historinë e marrëdhënieve të ndërsjella”. Sipas fjalëve të vetë studiuesve, “projekti mbështetet në përvojat e ndërmarrjeve kërkimore të kohëve të fundit në lidhje me kulturat evropiane të kujtesës, duke futur një element deri më tani të munguar në to: mishërimin në historinë e marrëdhënieve dypalëshe”. Lieu de mémoire i Norës ishte korniza e miratuar nga gjermanët dhe polakët. Cila mund të jetë korniza kritike e miratuar nga bullgarët dhe maqedonasit? Kjo mbetet një pyetje e hapur.

Vjollca Krasniqi

Faleminderit, Naum. Faleminderit që e sollët ndërliqësinë e transnacionalizmit në politikën e kujtesës në kornizën e BE-së, e cila, mendoj, lidhet shumë mirë me prezantimin e Anës. Do të shkojmë te panelistja jonë e katërt, Venera Çoçaj. Venera, fjala është për ty.

Venera Çoçaj

Sot, unë do të flas për Kosovën dhe do të përqendrohem në tri tema. E para do të jetë korniza etno-kombëtare. E dyta, unë do të vështroj dinamikën gjinore. Dhe, së fundmi, unë do të tregoj disa shembuj të aktivizimit të kujtesës në Kosovë.

Kur flasim për kornizën kombëtare dhe kujtesën në Kosovë, ne nuk mund t'i shmangim vitet e1990-ta. Është e qartë se praktikat mbi-zotëruese të kujtesës janë përkujtimi i Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), si në praktikat institucionale, ashtu edhe në ato private të përkujtimit. Narrativa e zhvilluar është ajo “narrativa e heronjve” dhe e UÇK-së si një grup, i cili e ka sjellë sigurinë dhe paqen për shqiptarët e Kosovës në kohë të vështira dhe, gjithashtu, si një përforcues i përkatësisë etnike kombëtare. Pjesëtarët e UÇK-së perceptohen si “etërit themelues” të cilët e kanë çliruar Kosovën dhe e kanë sjellë paqen.

Ky rrëfim është shfrytëzuar nga partitë politike. Në të vërtetë, partitë e mëdha politike e përdorin këtë ndjenjë. Një numër i madh i monumen-


teve janë ndërtuar për të nderuar UÇK-në. Shumë anëtarë të UÇK-së janë bërë udhëheqës të partive politike dominuese në Kosovë. Kjo shkon paralelisht me njohjen ligjore. UÇK-ja sot është një grup i njohur ligjor në Kosovë - krahasuar, për shembull, me viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës. Familja e një veterani mund të jetë trashëgimtare e një pensioni pasi ata të kenë vdekur, por nuk është e njëjta gjë për familjet e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës.

Ky mbizotërim i kujtesës është shumë interesant, pasi tregon se cilat grupe nuk janë mbizotëruese. Pakicat etnike nuk janë aq të dukshme në Kosovë. Dhe në sferën publike, gratë nuk janë pjesë e praktikave të kujtesës si dhe as e lëvizjeve dhe e rezistencave të tjera politike, që kanë qenë jashtë ombrellës së UÇK-së.

Një shembull i nismave institucionale është Sheshi “Zahir Pajaziti” në Prishtinë (shih imazhin 1). Zahir Pajaziti ishte komandant i UÇK-së. Në qytete të tjera ka sheshe të ngjashme si ky. Dhe këtu po paraqes një foto të “Qendrës Rinore dhe Sportive Adem Jashari” në Prishtinë, e cila është ndërtuar gjatë kohës socialiste. Emri origjinal i kësaj qendre ishte për nder të dy partizanëve, “Boro dhe Ramizi”, për të simbolizuar

IMAZHI 1:
Përkujtimi i rezistencës së armatosur: Statuja e Zahir Pajaziti në sheshin me emrin e tij.

Autore: Venera Çoçaj



ideologjinë socialiste të bashkim-vëllazërimit. Sot, emri është ndryshuar në “Adem Jashari”, për të nderuar themeluesin e UÇK-së (shih imazhin 2). Për më tepër, shumë rrugë dhe shkolla janë emëruar “Adem Jashari”, madje përtej nismave institucionale - për shembull, aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës. Pandeh se e dini historinë tragjike të Adem Jasharit dhe të familjes Jashari, ku më shumë se 50 anëtarë të familjes kanë vdekur gjatë sulmit. Gratë dhe fëmijët e familjes Jashari nuk përkujtohen në hapësirën publike në mënyrën si është përkujtuar themeluesi i UÇK-së.

IMAZHI 2: Qendra Rinore dhe Sportive Adem Jashari.



Autore: Venera Çoçaj

Është interesante që në Kosovë ka nisma të shumta private të familjeve, të cilat ndërtojnë monumente për anëtarët e familjes së tyre që janë vrarë në luftë si luftëtarë të UÇK-së. Kjo fotografi është realizuar në fshatin tim, Gjonaj, prej nga vijnë prindërit e mi. Në anën e majtë mund të shohim monumentin privat që është ngritur këtë vit nga familja e Reshat Çoçajt (shih imazhin 3). Ai ishte një ushtar i UÇK-së dhe, në të djathtë, është ndërtesa e qendrës kulturore, e quajtur gjithashtu sipas Reshat Çoçajt (shih imazhin 4). Kjo është në një fshat të vogël afër Prizrenit. Është interesante të shihet se si nismat private dhe ato publike shkrihen në mes tyre.

IMAZHI 3: Statuja e luftëtarit të UÇK-së, Reshat Çoçaj



Burimi: telegrafi.com, 2020.

IMAZHI 4: Përkujtime në Qendrën Kulturore Reshat Çoçaj në fshatin Gjonaj.



Burimi: Gazeta e Prizrenit.net, 2020.

Përkujtimet publike mund ta sfidojnë kornizën etno-kombëtare. Një shembull i kësaj është pllaka përkujtimore në Mitrovicë. Këtë vit, komuna e Mitrovicës ka nderuar civilët, të cilët kanë humbur jetën në tregun e gjelbër në Mitrovicë. Në imazhin e parë, ne mund të shohim vetëm emrat e gjashtë viktimave (shih imazhin 5). Të gjithë janë emra shqiptarë. Pas një hulumtimi të hollësishëm nga studiuesi dhe aktivisti kosovar, Shkëlzen

Gashi, është zbuluar se viktima e shtatë ishte një vajzë e re rome, emri i së cilës nuk ishte përfshirë në pllakë nga Komuna e Mitrovicës.

IMAZHI 5: Monumenti kushtuar viktimave të bombardimeve në Mitrovicë, pa emrin e Elizabeta Hasanit.



Burimi: EkonomiaOnline.com, 2020.

IMAZHI 6: Ndërhyrja qytetare për përkujtimin gjithëpërfshirës në Mitrovicë.



Burimi Exit.al, 2020.

Kjo ka shkaktuar një diskutim të gjerë publik. Në imazhin e dytë, ju mund të shihni protestat e qytetarëve lokalë, të cilët kërkojnë që emri i vajzës rome, Elisabeta Hasani, të përfshihet në pllakë (shih imazhin 6). Pas këtij

reagimi publik, komuna e Mitrovicës ka kërkuar falje dhe e ka ndryshuar pllakën duke e shtuar emrin e Elisabeta Hasanit (shih imazhin 7). Ky është një nga shembujt nga më të fundit ku ne mund të shohim publikun dhe qytetarët të angazhohen me institucionet publike dhe të kenë një ndikim pozitiv. Sidoqoftë, do të kishte qenë shumë më mirë nëse komuna e Mitrovicës ta kishte vendosur fillimisht emrin e saj aty.

IMAZHI 7: Pllaka përkujtimore me emrin e përfshirë të Elisabeta Hasanit



Burimi: PrishtinaInsight.com, 2020.

Lidhur me gjininë, është e qartë se gratë janë më pak të përfaqësuara në praktikën e kujtesës në Kosovë, si dhe në rajon. Përpijekja e fundit që pëndodh në Kosovë ka të bëjë me dhunën seksuale gjatë luftës. Dhe kjo e ka bërë Kosovën një nga vendet e para në rajon që e njeh dhunën seksuale gjatë luftës. Dy shembuj kanë rëndësi këtu. Është fakt që të mbijetuarit nuk flasin, por monumentet, botimet dhe OJQ-të flasin në emrin e tyre. Është e rëndësishme të zbërthejmë atë që ata në të vërtetë nënkuptojnë. Unë do t'i tregoj dy nisma: monumentin “Heroinat” dhe instalacionin artistik “Mendoj për ty”, të dyja përfunduar në vitin 2015 (shih imazhin 8). Monumenti “Heroinat” është shumë interesant. Ishte një nismë parlamentare e bërë nga ish-deputetja e parlamentit, Alma Lama. Monumenti përfaqëson 20,000 gra që mendohet se kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. Monumenti ka një kuptim të dytë - njohjen e kontributit të grave në luftën e Kosovës. Sidoqoftë, ajo pjesë është mjaft e paqartë dhe e paqartësuar nga autori i monumentit.

IMAZHI 8: Gratë dhe kombi: Memoriali *Heroinat*.



Autore: Venera Çoçaj

Këto përkujtime janë vendosur brenda kornizës etno-kombëtare, pasi ato as nuk i sfidojnë dhe as nuk i pranojnë viktimat nga grupet jo-shumicë. Është “Heroinat” - është në gjuhën shqipe. Memoriali “Heroinat”, gjithashtu, projektton një imazh se si duhet të duket një grua shqiptare. Instalacioni artistik “Mendoj për ty», nga artistja Alketa Xhafa Mripa,

mbështetur nga Presidentja e atëhershme Jahjaga, është prezantuar në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht (shih imazhin 9). Qytetarët kanë dhuruar veshje ose funde për të përfaqësuar zërat e të mbijetuarve, por, në fakt, ky akt nuk i ka sfiduar rolet gjinore. Ka një fokus në marrëdhëniet shqiptaro-serbe dhe komunitetet e tjera jo-shumicë në Kosovë, të tilla si romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, nuk janë të dukshme.

IMAZHI 9: Luftimi i stigmës së dhunës seksuale gjatë luftës: Instalacioni artistik *Mendoj për ty*



Burimi: [PrishtinaInsight.com](https://prishtinainsight.com), 2020.

Dhe këtë vit, një nga monumentet më të njohura në Prishtinë, “Newborn”, i cili përfaqëson pavarësinë e shtetit të Kosovës, e ka përfshirë çështjen e dhunës seksuale gjatë luftës. Në çdo Ditë të Pavarësisë, monummenti «“Newborn “ mbart një temë të re. Këtë vit, tema e monumentit ishte dhuna seksuale gjatë luftës (shih imazhin 10). Ai përshkruan të gjitha viktimat e abuzimit seksual në konflikte në të gjithë botën, por edhe ato me përqendrim në Kosovë. Rrëfimet janë në gjuhët angleze dhe shqipe, por jo aq shumë në gjuhët jo-shumicë. Kjo ishte pjesë e fushatës “Bëhu Zëri im” dhe mund të shihni se shumë media e kanë përcjellë ngjarjen.

IMAZHI 10: Monumenti NEWBORN: Përkujtimi i dhunës seksuale gjatë luftës



Autore: Venera Çoçaj

Unë tash do të flas shkurt për aktivizmin e kujtesës. Studiuesit dhe aktivistët e kanë sfiduar idenë se viktimat ishin vetëm ato shqiptare. Po, kryesisht ata ishin shqiptarë, por kishte edhe viktimat nga grupet e tjera etnike. Kjo thuhet kur në Kosovë shënohet dita ndërkombëtare për të zhdukurit. Ideja është që të vendosen të gjithë emrat e viktimave, për t'u siguruar që nuk ka diskriminim etnik. Gjithashtu, ekspozita “Na ishte njëherë e dhe kurrë mos qoftë më”, e organizuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH), është një shembull tjetër i mirë (shih imazhin 11). Është kjo një ekspozitë, e cila përqendrohet në humbjet njerëzore, posaçërisht tek fëmijët në Kosovë. Është një shembull i mirë, pasi FDH ka bashkëpunuar me komunën e Prishtinës, shembull i asaj se si shoqëria civile mund të kontribuojë që praktikatat multi-narrative të bëhen institucionale. Shumë studentë në Kosovë dhe nga jashtë kanë mundësinë të shohin këtë ekspozitë.

IMAZHI 11: Fëmijët viktimë të luftës: Ekspozita *Na ishte njëherë dhe kur-rë mos qoftë më*



Burimi: Koha.Net, 2020.

Pse është kjo e rëndësishme? Tekstet aktuale para-universitare përmbajnë informacione çorientuese. Për shembull, ky është një citat nga libri i historisë për klasën e 10-të në Kosovë, i cili thotë se gjatë bombardimeve të NATO-s, ushtria serbe ka vrarë më shumë se 15,000 shqiptarë. Numri i viktimave të luftës është më i ulët se ky, dhe jo vetëm shqiptarët janë vrarë, por, gjithashtu, ka viktimë edhe nga grupe të tjera etnike.

Përse është i rëndësishëm studimi i kujtesës dhe, po ashtu, përse është i rëndësishëm edhe debati publik? Sepse ka të bëjë me lirinë e fjalës. Kjo sjell ndërmend rastin e Shkëlzen Gashit. Ai ishte këshilltar i ish Kryeministrit, Albin Kurti, i cili në një intervistë tha se “individë të UÇK-së mund të kenë kryer krime lufte”. Gashi i referohej raporteve të Amnesty International dhe Human Rights Watch. Ai publikisht është izoluar si antishqiptar. Dhe, si rezultat, ai u hoq nga posti i tij këshillues në qeverinë e Kosovës.

Kjo flet shumë për atë se sa e vështirë është të sfidosh kujtesën mbi-zotëruese të UÇK-së. Nëse kthehemi këtu, shohim banerin i cili është vendosur në sheshin kryesor në Prishtinë. Në baner është shkruar: «He-

ronjtë të luftës dhe të paqes”, që përshkruan presidentin aktual Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, udhëheqësin e Partisë Demokratike të Kosovës (shih imazhin 12). Ne gjithashtu shohim logon “UÇK”. Ndjenjat për UÇK-në janë të fuqishme dhe përdoren politikisht, veçanërisht tash kur Dhomat e Specializuara janë duke punuar në raste të veçanta. Në përgjigje të kësaj, kishte një nxitje nga kjo parti politike për të hartuar një ligj mbi “Mbrotjen e Vlerave të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”. Publiku i Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare e kanë refuzuar këtë ligj, duke thënë se ai pengon lirinë e fjalës; prandaj nuk kaloi.

IMAZHI 12: Burrëria dhe heroizmi në luftë dhe paqe.



Burimi: IndeksOnline, 2020.

Në përgjithësi, përkundër disa përpjekjeve për aktivizmin e kujtesës dhe përqendrimin në çështjet gjinore, është ende e vështirë të përfshihen perspektiva multi-narrative, të cilat e sfidojnë kornizën etno-kombëtare. Faleminderit.

Vjollca Krasniqi

Faleminderit Venera për sjelljen e çështjeve gjinore në diskutimin tonë të politikës së kujtesës dhe të praktikave të përkujtimit. Përfundimisht, një temë shumë e rëndësishme dhe, gjithashtu, siç e kanë theksuar edhe folësit e mëparshëm, temë e cila lidhet me dinamikën e përf-

shirjes dhe të përjashtimit në politikën e dhe në praktikat e kujtesës. E shoh se i kemi katërmëdhjetë minuta për të kaluar para përfundimit të panelit dhe unë do të doja t'iu jepja mundësinë pjesëmarrësve në panel për pyetje.

Ju lutem mos ngurroni të përdorni kamerën tuaj kur flisni, dhe / ose të bisedoni për t'iu drejtuar pyetje panelistëve tanë.

Ndërsa jam duke pritur për pyetje nga audienca, unë do të doja të vazhdoja me një raund pyetjesh. Do të doja të filloja me Anën. Ana, a mund të na jepni një ose dy shembuj të përvetësimit selektiv të normave të kujtesës në BE dhe se si ato praktikohen aktualisht në Ballkanin Perëndimor. Ju argumentuat se nuk ka memorie të përbashkët evropiane. Çfarë do të thotë kjo në kontekstin e BE-së sot dhe për të ardhmen?

Ana Milosheviq

Mua më pëlqejnë pyetjet sfiduese. Do të doja t'ia fillojë me pyetjen sfiduese. Ajo që e thashë ishte se nuk ka kujtesë evropiane. Nuk ka asnjë rrëfim unifikues në BE për atë se cila ka qenë e kaluara. Ekzistojnë një numër shembujsh se si është shkarkuar korniza e kujtesës e BE-së në vendet e Ballkanit Perëndimor. Dhe, sigurisht, një shembull që më vjen në mendje është ai i gjenocidit të Srebrenicës dhe fakti që BE, dhe posaçërisht Parlamenti Evropian, po ushtrojnë një lloj trysnie mbi Serbinë për të pranuar atë që ka ndodhur në Srebrenicë.

Kushdo që e ka hulumtuar politikën e kujtesës në Serbi ose politikën e kujtesës në nivelin evropian e din se Parlamenti Evropian e ka miratuar një rezolutë - në të vërtetë, një numër rezolutash - për të siguruar mbështetje për familjet e viktimave. Ngjarjet e gjenocidit e kanë shtyrë këtë rezolutë në nivelin evropian dhe kanë ushtruar një lloj trysnie mbi Serbinë për të pranuar atë që ka ndodhur atje. Në një moment të caktuar në kohë, parlamenti serb e ka kaluar një rezolutë, e cila i sheh ngjarjet e Srebrenicës si diçka që ishte e gabuar - megjithëse parlamenti serb kurrë nuk e ka njohur atë si një gjenocid. Përse atëherë parlamenti serb e ka miratuar rezolutën? Pasi nuk ishte diçka që shkon në përputhje me politikën e kujtesës zyrtare të Serbisë. Parlamenti serb e ka bërë atë, sepse ata donin të lëviznin më shpejt në rrugën e anëtarësimit në BE.

Ky është një nga shembujt, por ka një numër shembujsh të këtij shkar-

kimi që ndodh në të vërtetë në një numër vendesh, gjë që më çon në pikëpamjen time: se unë jam me të vërtetë, me të vërtetë, me të vërtetë skeptike për suksesin e memorializimit dhe përdorimet e tij për drejtësi simbolike dhe për reparacionet për viktimat, për komunitetet lokale. Unë njëmend jam, me të vërtetë jam skeptike, skeptike në lidhje me këtë. Unë, gjithashtu, mendoj se, në të vërtetë, ka një mungesë kërkimesh mbi këtë çështje, mbi popullaritetin e kujtesës si një mjet i drejtësisë dhe i reparacionit simbolik, si dhe mbi efikasitetin e këtyre llojeve të ndryshme të përkujtimit në drejtësinë tranzicionale dhe kontekstet post-traumatike.

Vjollca Krasniqi

Vjerani na e ka ofruar një pamje më optimiste, apo jo, Vjeran? Ju e keni theksuar se e zbuloni një ndryshim të nuancuar në ligjërimin publik në drejtim të praktikave të përkujtimit dhe kujtesës në Kroaci. Por ka edhe një anë të zymtë të saj, po ashtu. A mund të na ofroni pak nga ky plan optimist?

Vjeran Pavllaković

Gjatë tryezës së rrumbullakët të “Operacionit Stuhia” të kësaj vere, unë isha gjithashtu optimist, ndërsa kolegu im Sven Milekiq nga BIRN-i ishte kundërpesha ime pesimiste. Argumenti i tij ishte: Kush lodhet që disa politikanë janë paraqitur në një përkujtim dhe më pas asgjë praktike nuk është arritur? Por, ju e dini, unë mendoj se politika simbolike ka një ndikim. Me Presidentin Ivo Josipović, disa vjet më parë, asgjë praktike nuk ka ndryshuar dhe marrëdhëniet serbo-kroate, në të vërtetë, janë përkeqësuar. Atëherë mund të thuash, në rregull, nuk ka me të vërtetë një efekt afatgjatë. Por, nëse mbështetet nga nisma konkrete lokale, që përkrahen nga një vullnet i qartë politik në nivelet më të larta të shtetit, kjo mund të krijojë ndryshim të vërtetë dhe jo vetëm një mundësi fotografie gjatë një ceremonie të vendosjes së kurorave.

IMAZHI 12: Përkujtim në Varivode në monumentin e ngritur rishtas në kujtim të nëntë civilëve serbë të Kroacisë të vvarë, 5 tetor 2010.



Autor: Vjerran Pavllaković

Nëse këto lloje të reja të politikës së kujtesës mund të inkurajojnë serbët e Kroacisë që jetojnë në Serbi që të kthehen dhe të krijojnë një situatë të re në terren, kjo mund të mbështetet nga aktivistë, akademikë, gazetarë, anëtarë të bashkësive fetare dhe aktorë të tjerë shoqëror, të cilët ndihen të fuqizuar nga atmosfera e përgjithshme politike dhe jo nga ndjenja se ata vazhdimisht po sfidojnë rrëfimin shtetëror hegjemonist. Unë kam punuar me kolegë në Kroaci dhe Serbi më shumë se dhjetë vjet në konferenca dhe në seminare në lidhje me marrëdhëniet serbo-kroate dhe ka pasur një ndjenjë që nuk ka ndodhur shumëçka; por, një ndryshim si ky nga lartë frymëzon nisma të reja për të ecur përpara.

Le të shohim se çfarë ndodh në përkujtimin e Vukovarit, edhe pse shumë politikanë të krahut të djathtë kanë paralajmëruar se nuk duan që Vukovari të jetë një Knin tjetër. Kundërshtarët më të mëdhenj të pajtimit kanë deklaruar se nuk duan që shteti t'iu tregojë atyre se si t'i bëjnë përkujtimet. Sidoqoftë, le të themi se jam optimist i kujdesshëm dhe mendoj se Kroacia është duke ecur përpara në një drejtim pozitiv në lidhje me politikën e kujtesës.

Venera Çoçaj

Të jem e singërtë, të thuash diçka optimiste është shumë e vështirë - të mendosh për historinë institucionale dhe librat shkollorë që janë të ndarë dhe të polarizuar përgjatë vijave etnike. Për sa kohë që kjo po ndodh, i gjithë ky aktivizëm pozitiv i kujtesës është i hapur për debat. Sa kanë ndikuar këto në brezat e rinj që, në të vërtetë, nuk mbajnë mend asgjë nga vitet e 1990-ta? Kjo është një çështje problematike. Por, gjithashtu, projektet e pajtimit dështojnë. Kemi parë, kohët e fundit, në botimin që buron nga projekti hulumtues “Libri i Historisë së Përbashkët të Projektit”, se ka interpretime shtrembëruese për Kosovën dhe shqiptarët si dhe për pozicionin e shqiptarëve të Kosovës në ish-Jugosllavi. Unë nuk kam një përgjigje të qartë për këtë.

Vjollca Krasniqi

Ju faleminderit. Ju faleminderit të gjithëve për prezantimet interesante dhe për ndarjen e mendimit, hulumtimit tuaj, dhe, gjithashtu, për udhëzimet e ardhshme mbi politikën e kujtesës dhe praktikën e përkujtimit në Kroaci, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi. Të gjithë ju keni prekur rëndësinë e arsimit dhe të kërkimit si dhe nevojën për të mbajtur një sferë përfshirëse publike ku tregime, kujtime dhe përvoja të ndryshme përfaqësohen dhe diskutohen në një mënyrë të mirëfilltë demokratike.

Ju faleminderit shumë. Ju faleminderit edhe në emër të FDH Kosovë. Shpresoj se do të takohemi përsëri në ngjarjet e ardhshme të FDH-së në Kosovë dhe KOMRA-së.

